




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot B: Prot Prot No 01-1108/13
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 15.04.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **03.04.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllen rastet me Nr. AKK-03-444/13, për znj. *Leonita Shabani – Këshilltare Politike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-444-13, për Zyrтарen e lartë, znj. Leonita Shabani – Këshilltare Politike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, dhe njëkohësisht njëra nga personat e autorizuar të një biznesi privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-444/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarja e lartë, znj. Shabani së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia, (DPK-01-663/13), pas të cilës zyrtarja është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Zyrtarja Shabani është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, për të vazhduar të ushtroj funksionin e saj publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, Zyrtarja e lartë, znj. Shabani në Agjenci ka sjellur një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-904/13) në të cilën ka sqaruar se i ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznes duke hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar dhe bashkë me këtë shkresë i ka ngjitur edhe informacionet e reja të biznesit të lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në informata të së cilës shihet se znj. Shabani, tashmë, ka hequr dorë nga funksioni i saj si Person i autorizuar i biznesit privat “Element Kosovo Technology Investment” sh.p.k.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

